



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.74.

Prishtinë, më 02.04.2024, në orën 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola-kryetar, Albena Reshitaj, Enis Kervan, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj dhe Vlora Dumoshi.

Munguan: Adriana Matoshi, Arjeta Fejza, Eliza Hoxha dhe Ardian Kastrati.

Pjesëmarrës nga Komisioni për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë: Flutura Açka, kryetare, Evis Kushi, Lindita Buxheli, Petro Koçi, Ilir Topi, Andia Ulliri, Eralda Bano- Tase, Kastriot Piroli, Merita Bakiu, Orjela Nebijaj dhe Luljeta Bozo.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Takim me Komisionin për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Ardian Gola, tha se fatkeqësisht jemi në një periudhë të homazheve gjithandej Kosovës, dhe për këtë arsye, kemi edhe disa mungesa nga deputetët.

Tani, ju uroj mirëseardhje për këtë vizitë dhe urojmë që edhe kjo vizitë të jetë si pjesë e përpjekjeve tona për të konkretizuar idetë tona. Tashmë, si komision, kemi kaluar një mori ligjesh, të cilat synojnë reformë të thellë strukturore të fushave të gjendjes. Për shembull, Ligji për kulturën ka bërë një reformë shumë të madhe në nivel strukturor të kësaj fushe, do të shohim se si kjo reformë do të prodhojë efekte për zhvillimin kulturor të vendit. Është gjithashtu Ligji për rininë, i cili tashmë është në proces, preket e tërë struktura dhe rinia bëhet përgjegjësi horizontale e të gjitha dikastereve qeveritare. Një mori reformash po bëhen edhe në arsim, kemi kaluar Ligjin për edukimin në fëmijërinë e hershme, kemi një agjenci që fatmirësisht po tregon sukses në mënyrën sesi menaxhohen në përgjithësi proceset, tashmë kemi realizuar dhe mori reforma të tjera, të cilat presim që të kalojnë, është Ligji për tekstet shkollore, është Ligji për arsimin profesional etj. Jemi në vit zgjedhor dhe efektiviteti mund edhe të afektohet, por po bëjmë atë çfarë është më e mundshme, për të pasur një performancë të mirë, si parlamentarë të kësaj legjislature. Kemi shumë pika, të cilat është mirë që të adresohen në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Si komision, kemi disa preokupime të përbashkëta, duke mbajtur vazhdimisht në mendje pasionin e jashtëzakonshëm që kryetarja Aça ka për drejtshkrimin. Për këtë pikë, ne mund të konkretizojmë diçka, si dy komisione. Meqë flasim për gjuhën, flasim realisht për identitetin. Ato pak a shumë janë synimi me të njëjtën gjë, kështu që në këtë kontekst, edhe ky takim të jetë në frymën e këtij diskutimi dhe këtij materializmi të ideve.

Flutura Aça: Është kënaqësi e veçantë të jemi këtu bashkë, e shoh si një vazhdim të bisedës që kemi bërë në Shqipëri dhe mendoj që ka qenë e frytshme, kemi shumë gjëra, sidomos në fushat që do t'i mbulojmë me arsimin dhe kulturën, për marrëveshjet, për ligjet që kemi kaluar në komision dhe çështjet që jemi të interesuar për Ligjin për fëmijërinë e hershme. Përveç këtyre marrëveshjeve, që kanë kaluar në komisionin tonë, kemi çështjet e mbetura pezull dhe të paavancuara të marrëveshjes së vitit 2023, që është bërë mes dy qeverive tona. Kam përshtypjen që këtu ka disa çështje që duhet të adresohen, pse nuk kemi rezultate, kjo do të ishte një gjë që duhet të jetë në vëmendje të të dy komisioneve, që punët që i kemi lënë duhet t'i çojmë ato deri në fund. Do të ishte një gjë shumë e mirë, dy projektet ambicioze që kemi me akademitë, ai i fjalorit reciprok dhe i fjalorit të gjuhës shqipe, kështu që do t'ju mbajmë në dijeni se çfarë do të rezultojë nga raporti vjetor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për dy projektet e mëdha mbarëkombëtare. Në komisionin tonë, ka çështje të mbetura, që ne të mësonim nga ju për IT-në, e nga ana jonë, mund të ketë ndoshta për turizmin ose ndonjë degë që mund të jetë shumë tërheqëse për studentët e juaj. Meqenëse ky vit është viti i gjuhës shqipe, i shpallur në Shqipëri dhe një konferencë mbarëkombëtare për gjuhën, ku përfaqësues të Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës, nëse do të ishte e mundur, edhe kjo ishte e fundit, sigurisht edhe diaspora në përgjithësi.

Enis Kervan, tha se shteti shqiptar gjithmonë është ambasadori më i fuqishëm i Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në Kosovë, me programet dhe kurrikulat kosovare, përveç gjuhës shqipe, arsimi

zhvillohet edhe në gjuhën turke dhe boshnjake, në të gjitha nivelet, kemi edhe komunat si në Komunën e Prizrenit, komuniteti rom mëson gjuhën amtare romë, në një shkollë. Domethënë, kur flitet për arsimim, mendoj që në rajon nuk ka më shumë avancime apo të drejta se që ne kemi në Kosovë. Edhe te çështja e arsimit në universitete, mjafton në universitetet publike në Prizren, Prishtinë, Pejë kemi programe në gjuhën turke dhe boshnjake. Tekstet shkollore edhe komuniteti turk, edhe komuniteti boshnjak ka të gjitha tekstet shkollore në gjuhën turke dhe boshnjake.

Merita Bakiu: Është kënaqësi të jemi pjesë e një komisioni që do ta quaj vëllazëror, për të ndarë përvojat tona të dy komisioneve. Unë mendoj që ne, të dy komisionet, kemi shumë punë për të mbushur detyrën tonë, si deputetë, përpara qytetarëve. Tek arsimit parauniversitar, do të ndalesha te kurrikulat, te tekstet dhe te programet që janë baza e arsimit, duhet të keni një trajnim dhe kualifikim të mësimdhënësve, qoftë në Shqipëri, qoftë edhe në Kosovë. Në qershor të vitit 2014, është nënshkruar një marrëveshje për unifikimin e kurrikulave midis Kosovës dhe Shqipërisë. Abetarja e parë, unifikimi i abetares, ka filluar deri në vitin 2012 dhe u deshën dhjetë vite, pasi të bëhej unifikimi me Kosovën. Sot, që ne kaluam në këtë dhjetëvjeçar, mund të kishim arritur në unifikimin e të gjitha teksteve shkollore. Ne duhet të kemi një grup pune të përbashkët ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës për hartimin e historisë kombëtare, që kanë problematikat nga më të ndryshmet në tekstet e historisë së Kosovës. Lufta është trajtuar shumë pak dhe nuk i dinë se çfarë ka kaluar pjesa e Kosovës, dhe që duke mos njohur të shkuarën, nuk mund të ecim më përpara. Kjo që i duhet këtij kombi, është gjuha dhe historia. Prandaj, mendoj që duhet të kemi një grup pune të përbashkët, sa i përket kësaj, të fillojmë shpejt fushën e trajtimit të mësuesve me marrjen e shkëmbimeve dhe të përvojave, programe pune të përbashkëta ndërmjet shkollave të arsimit të parë universitar në Shqipëri dhe në Kosovë, duhet të kemi olimpiadat të përbashkëta, për të parë sesi dhe ku kanë arritur të gjitha aktivitetet e ndryshme sportive, kulturore, në mënyrë që të bëjmë edhe lidhjen sa më shumë të dy vendeve tona.

Ardian Gola: Për tekstet shkollore, meqë ne e kemi një proces të amendamentimit edhe një takim i grupit punues të Kuvendit të Kosovës dhe të Shqipërisë, mbase mund të ndihmojë në marrjen e përvojave të tyre.

Albena Reshitaj, tha se gjëja më thelbësore që mund ta nderë këtë takim, tek secili nga ne, për një bashkëpunim të madh e më të ngushtë në mes nesh, si politikanë, por edhe si anëtarë të këtij komisioni kaq të rëndësishëm, arsimit në kulturën tonë, është një segment thelbësor i historisë, qytetërimit dhe mendimit pedagogjik. Studimet dhe analizat e kësaj fushe ofrojnë një perspektivë të pasur në kulturën dhe identitetin tonë, këndej e andej alpeve shqiptare. Komisionet që kanë një rol kryesor në zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave arsimore, duke pasur rolin kryesor në hartimin dhe zhvillimin e politikave, janë në dritën e përpjekjeve tona të përbashkëta për të përparuar në fushën e arsimit dhe për të ndarë përvojën ideale strategjike, për të përmirësuar sistemin arsimor, Pres që nga këto takime pune konkrete, që sa më parë të arrijmë një arsimim të unifikuar Kosovë-Shqipëri, duke ndihmuar njëri-tjetrin me strategji të përbashkëta në ngritjen e cilësisë së arsimit, përgjatë institucioneve arsimore, meqë arsimimi konsiderohet si një instrument udhëheqës i rritjes ekonomike që të jemi konkurrentë në tregun e punës, jo vetëm brenda vendeve

tona, por edhe jashtë vendit, e konsideroi shumë të rëndësishëm, një bashkëpunim që do të kishim mundësi ta kishim në pjesën e gastronomisë dhe hotelerisë, do të ishte një qëllim dhe interes i vendit tonë, që të krijojmë kuadro të reja në këtë fushë, pasi kemi edhe eksperiencë për t'i përgatitur, ndoshta edhe për të punuar në bregdetin shqiptar, të gjitha këto plazhet dhe rivierat që po ndërtohen në bregdetin shqiptar. Kemi një mungesë të një strategjie konkrete për arsimim dhe formim profesional gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuar. Politikat arsimore duhet të jenë të qarta dhe potencialisht të realizueshme, pavarësisht çmimit në financë. Investimi në arsim është pjesë e një politike të përgjithshme për zhvillimin e vendit dhe kërkon një investim strategjik specifik, afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Pra, është përgjegjësi e përbashkët për të ngritur cilësinë e arsimit, nevojën e thellimit të bashkëpunimit në institucion të arsimit të lartë, përfshirë kërkimet shkencore, si dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve, duke mobilizuar mekanizmat implementues, që të jenë në nivelin e duhur të zbatimit, në mënyrë që jetësimi i marrëveshjeve të përbashkëta të ndikojë drejtpërdrejt në fuqizimin e të dy fushave.

Evis Kushi, tha se e vlerësojmë jashtëzakonisht shumë dhe e kemi një nga prioritetet kryesore bashkëpunimin me Kosovën, në fushën e arsimit, kulturës dhe fushat tjera që mbulon komisioni. Sigurisht, jemi të pakënaqur në lidhje me disa marrëveshje që nuk kanë ecur siç duhet. Në thelb, ne nuk mund ta mohojmë atë punë që është bërë, sidomos gjatë viteve të fundit. Bashkëpunimi është intensifikuar shumë në fushën e arsimit dhe kemi rezultate konkrete, duke filluar që nga ajo abetarja, deri në projektet madhore në albanologji, mes dy akademive tona të shkencave, që po punojnë edhe për enciklopedinë, edhe për fjalorin e madh të gjuhës shqipe, po edhe për projektin e historisë. Ndërkohë, sa i takon arsimin parauniversitar, përveç abetares, tashmë edhe Olimpiada e Parë e Gjuhës Shqipe është vënë në zbatim, ka qenë një marrëveshje që e kemi firmosur vitin e kaluar, mes dy ministrive, për një konkurs të përbashkët të gjuhës shqipe. Para pak ditësh, edhe dy ministrat tanë zhvilluan një takim dhe ky projekt po ecën më së miri. Ndërkohë, te mërgata, tashmë janë dy tekste, që në fakt punohen në mënyrë të përbashkët midis Shqipërisë e Kosovës, është gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në diasporë. Niveli i parë dhe niveli i dytë është drejt përfundimit. Pra, është mirë që diaspora shqiptare konsiderohet një dhe e vetme, kudo në çdo vend të botës, çdo vit zhvillohet seminari i përbashkët i mësuesve të gjuhës shqipe dhe kjo është një nga marrëveshjet që zbatohet me sukses, ku një vit organizohet në Shqipëri, një vit në Kosovë, por ajo që ka çaluar ka qenë financimi i përbashkët, sepse dihen vështirësitë, por këtu duhet bërë më shumë përpjekje për të dy vendet tona, që të vendosim në buxhet një shumë të caktuar. Aktualisht, jemi duke punuar për Ligjin për librin dhe këtu, ne do të donim të kishim më shumë bashkëpunim, nëse ju keni një përvojë të mirë në Ligjin për librin. Ne e dimë vështirësinë që kanë fëmijët në diasporë, për ta ruajtur të pastër gjuhën shqipe, sepse sigurisht atje integrohen në jetën sociale, ndjekin shkollat në vendin ku jetojnë, dhe kjo bën që gjuha shqipe të humbasë pak, prandaj përpjekjet tona duhet të jenë shumë më të mëdha. Por, përveçse në diasporë, ne po shohim problematika me gjuhën shqipe edhe në vendet tona. Globalizimi nga njëra anë apo integrimi në Bashkimin Evropian dhe gjuha angleze, tani janë bërë gjuhë ndërkombëtare. Tani, duhet të bëjmë përpjekje të përbashkëta dhe strategji të përbashkëta, për të vendosur disa etiketa dhe pastaj të punojmë në të njëjtin drejtim, sepse kërcënimi është i përbashkët dhe rreziqet janë të njëjta, si në Shqipëri edhe në Kosovë.

Petro Koçi: Kur flasim për gjuhën, për shembull, është thelbi i të qenit tonë si komb, si shqiptar. Gjuha është e para, është flamuri, territori, popullsia, etj. Por, gjuha vjen në rrezik, ngaqë, me sa duket, sistemet tona arsimore kanë një lloj rënie në kuptimin e disiplinës së sistemit. Padyshim, në diskutim mbi kurrikulat, cilësia e mësimdhënies së mësuesve, padyshim, rrezikon më shumë, është rreziku i asimilimit nga proceset e integritit. Globalizimi, kështu që ne duhet t'i kundërpërgjigjemi vërtet me strategji të përbashkëta. Unë do të thosha që përtej diskutimeve, edhe me propozime konkrete, kemi nevojë për një platformë, e cila të jetë politikisht e qartë dhe e vendosur. Kjo do të thotë për mua, do të ishte e udhës, që ne të përcaktojmë një arsim të bashkuar, kulturë të bashkuar dhe shkencë të bashkuar, dhe pastaj, pas kësaj platforme, të përcaktimi politik vijë të gjithë hapat, jo se nuk po ecim, sigurisht që po ecim dhe ne duhet të duartrokasim shumë projekte, shumë marrëveshje të përbashkëta, që edhe po ecin, siç është rasti i tri projekteve themelore me interes kombëtar, siç është fjalori i madh i gjuhës shqipe, historia e shqiptarëve dhe enciklopedia shqiptare, janë themele dhe janë projekte historike.

Jahja Kokaj, tha se kam kënaqësi të veçantë, që jam para jush, kështu që kjo pjesë emocionale, ndoshta tash shkenca e vërteton, se inteligjenca emocionale ka përparësi edhe nga aspekti në krahasim me inteligjencën kognitive. Bashkimi i mendjes, thotë se bëhet nga këto, kurse njerëzit i bashkon ideja, është shumë determinante. Jam i interesuar, personalisht, për të dhënë kontributin sa më të madh të unifikimit të trurit kombëtar në kuptimin intelektual dhe shkencor, që të unifikohen kurrikulat, që të unifikohen pastaj edhe tekstet, prandaj unë propozoj që të bëhet unifikimi i teksteve shkollore, edhe kur është fjala për shkencë, teknologji, inovacion, propozoj që të bëhet qendra për ekselencë, sepse këto mungojnë edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri.

Lindita Buxheli, tha se duke qenë viti i gjuhës shqipe, këtu duhet përmendur që njëzet e dy nëntori është Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe, ku gjithnjë bashkë duhet t'i japim jehonë Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, por edhe në diasporë. Seminaret e ndryshme në Ministrinë e Arsimit, duhet të bëjmë më tepër për ato shkolla, duke qenë një pjesë e mirë e familjeve tona, janë në emigrim. Këtu mbetet shumë për të bërë, kështu që edhe njëherë, do t'i uroja suksese komisionit, në vazhdimësi, dhe të jenë më të shpeshta këto takime të përbashkëta.

Luljeta Bozo, tha se është detyrë e jona të hartojmë politika të atilla që e gjithë kjo popullsi, që është shqiptare, jashtë trevave shqiptare, ta ruajë identitetin me anë të gjuhës, kulturës dhe historisë, kështu që ne kemi një detyrë shumë të rëndësishme, t'i bashkojmë forcat, se veç e veç nuk ka lindur ndonjë gjë. Aty ku kemi shumicë, t'iu mundësojmë këto, pra të kemi diçka konkrete, që mund ta zbatojmë dhe ta kontrollojmë. Ne duhet patjetër që kjo shumicë ta mësojë historinë e tij dhe të ruajë traditat e kulturën, po ashtu edhe që të kemi kërkime shkencore të përbashkëta, sepse shkenca është truri, ajo që zhvillon ekonominë dhe dikastere të tjera.

Orjela Nebijaj, tha se meqenëse jam e re dhe në një farë mënyre, përfaqësoj të rinjtë që janë të ardhur, arsimit mbillet sot, e korret në mot. Nëse i bashkojmë forcat, mundemi minimalisht në buxhetet tona dhe në shtetet tona, që duan ende shumë punë që të fuqizohen, të bëjmë shumëçka. Pse jo, Prishtina të ecë përpara në një drejtim, Tirana në një drejtim dhe të paktën studentët tanë të

zgjedhin. Ajo çfarë i bën sot që të ikin larg, është fakti që ashtu si në Tiranë, por edhe në Prishtinë, kampuset, arsimi, e ardhmja, universitetet, nuk iu afrojnë dinjitetin që arsimi duhet të ketë, Në fakt, për fat të keq, dinjiteti ka humbur dhe për ata që japin dije, dhe për ata që marrin dije. Unë shpresoj që ky bashkëpunim të na i lehtësojë krahët, për atë të ardhme që nuk ka rëndësi nëse shkon edhe studion jashtë, por e kupton qartazi që dija duhet të kthehet në vend, ashtu si dhe profesori.

Vlora Dumoshi, tha se kemi pasur rastin të bashkëpunojmë në ministri të ndryshme, kemi nënshkruar edhe marrëveshje bashkë. Ne duhet ta pranojmë se jemi në një krizë dhe do të duhej të ishte alarm për të dy qeveritë tona, dhe ne si komisione vitale, është pjesa e emigrimit, ku kohëve të fundit, 300 mijë qytetarë janë larguar. E shohim se më shumë kemi shkolla sesa nxënës në to. Në mënyrë të heshtur, kemi edhe problemet e gjuhës shqipe. Tek fjalori i gjuhës shqipe nuk kemi fjalë të pasuruara ose rishikime që të përshtatemi edhe me kohën. Ne kemi nevojë për ju dhe ju për ne, andaj të qëndrojmë të bashkuar.

Pas diskutimeve, të dy komisionet u dakorduan në parim për organizimin e një dëgjese publike, në të cilën ministritë respektive do të raportojnë për ecurinë dhe sfidat eventuale në zbatimin e marrëveshjeve të arritura.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola,

Kryetar i Komisionit